

2011, përpunohen 3.5 milion ton mallra dhe afro 854 mijë udhëtarë

18.01.2012



Gjatë vitit të kaluar në portin detar të Durrësit janë përpunuar afro 3.5 milion ton mallra gjithsej, 21 përqind e të cilave janë transportuar me tragete. Gjatë së njëjtës periudhë tragetet kanë transportuar afro 854 mijë udhëtarë.

Sipas të dhënave statistikore të Autoritetit portual, bëhet e ditur se gjatë vitit që lamë pas në të dy sektorët kryesorë, të mallrave dhe udhëtarëve ka patur një rritje prej përkatësisht 2 përqind.

Gjatë vitit të kaluar janë përpunuar 69 mijë ton mallra më shumë se në vitin 2010. Afro një e treta e mallrave të transportuar kanë qenë të ambalazhuar në kontejnerët metalikë, duke rritur sigurinë e transportit dhe duke shmangur ndotjen e mjedisit. Gjatë periudhës janar-dhjetor anijet kanë transportuar 79.699 kontejnerë, (njësi kontejnerike TEU), afro gjysma e të cilave janë nisur përsëri drejt porteve të tjera

të ngarkuar me mallra të prodhuara në vendin tonë. Sasia e përgjithshme e mallrave me kontejnerë që janë përpunuar në Durrës arrin në 1 milion e 40 mijë ton.

Eksportet e vitit që lamë pas e tejkalojnë shifrën prej 1.3 milion ton mallra, ndërsa në listën e mallrave të importuara bëjnë pjesë hekuri, materialet e ndërtimit, plehtrat kimike e bujqësore, koksi, etj.

Nga të dhënat e Autoritetit portual mësohet se gjatë vitit 2011 tragetet kryen 7157 lundrime drejt Barit, Ankonës dhe Triestes. Megjithëse krahasuar me vitin paraardhës u realizuan 952 lundrime më pak vitin që kaloi u regjistruan 853.748 udhëtarë, ose rreth 20 mijë më shumë.

Shqiptarët zenë 59 përqind të numrit të udhëtarëve që kanë preferuar të lëvizin me tragete gjatë vitit të kaluar, ndërsa numri I autoveturave në të njëjtën periudhë ka arritur në mbi 185 mijë.

